



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:019145

Datë: 31.05.2018

Numri i dokumentit: 00049879

P.nr.519/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Diana Sina, me procesmbajtësen Lamije Kuqi – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit N. Z. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor, nga neni 188 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.775/2017, të datës 14.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datën **29.05.2018**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Enis Gashi, të akuzuarit, të dëmtuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **N. Z.**, i biri i R., i nënës M. e gjinisë S. data e lindjes.... në Gjakovë, ku edhe tani banon në lagjen B., Rr..... din shkrim dhe lexim, punëtor fizik, i martuar-atë i 4 fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, realizues i ndihmave sociale, rom, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse: Me dt.23.05.2017, rreth orës 14.00 min. në Gjakovë, në lagjen B., Rr.... pikërisht në oborrin e shtëpisë së tyre, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit – vëllait të tij B. Z., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje në mes të dëmtuarit dhe vëllait tjetër Xh. Z., rreth ndërtimit të një shupe në oborrin e tyre të përbashkët, në atë moment ndërhyjnë i pandehuri N., i cili papritmas e shtynë të dëmtuarin B., i cili rrëzohet për toke dhe bije në një hekur duke e lënduar vetullën e syrit të djathtë, me ç’ rast pëson lëndime të lehta trupore.

Me çka ka kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor, nga neni 188 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 41, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 188 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, ia shqipton:

D Ë N I M M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej **1(një) viti**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

I dëmtuari B. R. Z. nga Gjakova, lagja B. Rr., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.775/2017, të datës 14.08.2017, kundër të akuzuarit N. Z. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor, nga neni 188 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Enis Gashi, në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari N. Z. lidhur me fajësinë në shqyrtimin fillestar deklaroi, se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë dhe menjëherë pas rastit i kam kërkuar falje vëllaut tim B., i cili ma ka fal gabimin dhe tani nuk kemi asnjë mosmarrëveshje në mes veti, jetojmë së bashku në një shtëpi, shton se jam në gjendje të dobët materiale, jam realizues i ndihmave sociale, për herë të parë paraqitem në Gjykatë për një vepër të kryer penale por premtoi se do të jetë edhe hera e fundit.

I dëmtuari B. Z. deklaroi, se unë si palë e dëmtuar nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk kërkoj kompensimin e dëmit, vëllau im menjëherë pas rastit më ka kërkuar falje, unë ia kam falur gabimin dhe tani nuk kemi asnjë mosmarrëveshje në mes veti, përsëri jetojmë në të njëjtën shtëpi, andaj i propozoi gjykatës që të njëjtit ti shqiptoi një dënim sa më të but.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari N. Z.: Me dt.23.05.2017, rreth orës 14.00 min.në Gjakovë, në lagjen B., Rr.... pikërisht në oborrin e shtëpisë së tyre, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit – vëllait të tij B. Z., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje në mes të dëmtuarit dhe vëllait tjetër Xh. Z., rreth ndërtimit të një shupe në oborrin e tyre të përbashkët, në atë moment ndërhyjnë i pandehuri N., i cili papritmas e shtynë të dëmtuarin B., i cili rrëzohet për toke dhe bije në një hekur duke e lënduar vetullën e syrit të djathtë, me ç' rast pëson lëndime të lehta trupore.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës

gjkata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjkata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPP-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është baba i 4 fëmijëve, gjendjen e varfër ekonomike, është punëtor fizik, është mbajtës I vetëm I familjes, pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, Gjkata ka ardhur në përfundim se me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, Gjkata e mori në mbështetje të nenit 453 par.4 të KPPK-së, nga se detyrimi që ti paguaj shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe personave që ata detyrohen të mbështesin materialisht.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.519/17 me datë 29.05.2018

Procesmbajtësja,
Lamije Kuqi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:019145
Datë: 31.05.2018
Numri i dokumentit: 00049879